

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

1. Emërtimi

1.1. Emërtimi I shoqërisë është "**BAJA 7" Sh.p.k** më poshtë i quajtur "Shoqëria"

2. Personaliteti juridik

2.1. Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

3. Selia

3.1. Selia e Shoqërisë është në adresën: "**Kamez, Rruga Berisha, lagjja nr.1, ndertese 2 kateshe nr.57**". 3.2. Shoqëria mund të hapë dhe mbajë zyra dhe/ose të kryejë aktivitete në vende të tjera, brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë, si dhe të hapë ose mbyllë zyra në vende të ndryshme, përveç selisë së Shoqërisë, brenda territorit shqiptar.

4. Kohëzgjatja

4.1. Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

5. Objekti i shoqërisë do të konsistojë:

5.1. **Kembim valuator, exchange, moneygram .**

5.2. Shoqëria mund të kryejë çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

6. Kapitali i Shoqërisë

6.1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 2.500.000 Lekë e ndare në një kuotë.


6.2. Kapitali i Shoqërisë përbehet tërësisht nga kontribute në para dhe zotërohet nga ortakët e Shoqërisë si më poshtë vijon:

6.2.1 Ortaku themelues : Znj. Migena Baja zoterues i një kuote me vlerë të përgjithshme 2.500.000 Lekë që përben 100 % të kapitalit themeltar të shoqërisë. Kontributi i ortakut është në para. Kontributet do të derdhen mbas rregjistrimit të shoqërisë në Qendrë Kombëtare të Biznesit.

6.3. Kuotat janë të zakonshme dhe lirisht të transferueshme sipas kushteve të parashikuara në ligj dhe këtë Statut.

6.4. Përgjegjësia e ortakut për humbjet e Shoqërisë shtrihet deri në vlerën e pashlyer të kontributit të nënshkruar.

7. Asambleja e Përgjithshme



7.1. Asambleja e Pergjithshme eshte organi më i larte vendimmarrës i Shoqërise dhe merr vendime kur është mbledhur rregullisht, në perputhje me ligjin dhe me Statutin dhe janë të detyrueshme për të gjithë ortakët përfshirë ata që mungojnë.

7.2. Asambleja e Përgjithshme mblidhet në rastet e parashikuara nga Statuti, nga ligji në fuqi "Për tregtarët dhe shogërite tregtare", ligje të tjera dhe sa herë është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërise.

7.3. Asambleja e Pergjithshme mblidhet në selinë e Shoqërise ose në çdo vend tjetër të shënuar në njoftimin për mbledhje. Njoftimi për mbledhje i dërgohet me shkrim të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 (shtatë) dite përpara datës së mbledhjes. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.

7.4. Mbledhja e Asamblese së Pergjithshme thirret nga administratoret. Thirrja e Asamblese së Pergjithshme mund të kërkohej edhe nga ortaku ose ortakët që përfshijnë jo më pak se 5% të totalit të votave në Asambletë e Pergjithshme.

7.5. Asambleja mblidhet, çdo vit brenda gjashtë muajve nga data e mbylljes së vitit financiar, për miratimin e raportit të administatoreve, pasqyrave financiare dhe llogarive vjetore.

7.6. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

7.7. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shogërite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

7.8. Secili ortak ka të drejtën e pjesëmarrjes dhe votimit në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Votat e disponuara nga secili ortak janë në numër të barabartë me kuotat e zotëruara prej tij.


7.9. Secili ortak mund të përfaqësohet në mbledhjet e Asamblese nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë me autorizim.

7.10. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

8. Kompetencat e Asamblese së Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme vendos për:

8.1. Përcaktimin e politikave tregtare.



8.2.Ndryshimet e Statutit.

8.3.Emerimin dhe shkarkimin e Administratorit/ëve dhe caktimin e shpërblimit të tij/tyre.

8.4.Emerimin dhe shkarkimin e likuidatorit/ëve dhe eksperteve kontabël të autorizuar dhe shpërblimin e tyre.

8.5.Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë.

8.6.Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raportet e ecurisë së veprimtarisë.

8.7.Miratimin e zmadhimit dhe zvogelimit të kapitalit të Shoqërisë.

8.8.Përfaqesimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedime të tjera kundër administratoreve.

8.9.Shpërndarjen e fitimeve

8.10.Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë.

8.11.Çështje tjetër të caktuar nga ligji ose nga Statuti.

8.12.Cdo amendament i Aktit të Themelimit dhe Statutit.

8.13. Çfarëdo transaksioni të jashtëzakonshëm të Shoqërisë, duke përfshirë bashkimet, ndarjet, transferimet, likuidimet, etj.

8.14.Të gjitha aktet që përfshijnë një angazhim financiar të Shoqërisë.

8.15.Të gjitha instrumentet e transferimit të mallrave dhe / ose instrumenteve të Shoqërisë.

9. Shoqëria administrohet nga një ose disa Administrator, i/të cili/ët është/janë person fizik, i/të zgjedhur brenda ose jashtë bashkësisë së ortakëve, të cilët emërohen nga Asambleja e Përgjithshme.

10. Administratori/ët emërohet/ për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë riemërimi.

11. Administratori/ët shkarkohet/ nga detyra, në cdo kohë, me vendim të zakonshëm të Asamblese së Përgjithshme sipas ligjit.

12. Administrator i Shoqërisë caktohet Znj. Migena Baja lindur më 07.07.2002 në Tiranë dhe me banim në Tiranë identifikuar nepermjet Letërnjoftim me ID Nr.Personal K257070640.

Llogaria bankare të çelet nga Administrator i Shoqërisë Znj. Migena Baja

Nënshkruar sot me datë 15.03.2022

ORTAKET E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Migena Baja

